



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 23, Datë 10.02.2020

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGIJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN JANAR 2020.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 201, datë 04.12.2017, i ndryshuar me vendimet e bordit të ERE nr. 201, datë 04.12.2017 dhe Nr. 233, Datë 20.12.2019; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 03.09.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.314 Prot, datë 09.01.2020, përparitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin Janar 2020,

**Konstatoi se:**

- FSHU sh.a. me shkresën nr. 1564 Prot, datë 04.02.2020, protokolluar në ERE me nr. 401 Prot, datë 05.02.2020, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin janar 2020.
- FSHU sh.a. ka informuar mbi procedurën e blerjes së energjisë nga tregu i parregulluar për mbulimin e sasisë për t’u furnizuar nga FSHU sh.a. për klientët fundorë për muajin Janar 2020.
- Nga aplikimi i paraqitur në ERE vërehet se janë zhvilluar tre procedura për blerjen e energjisë elektrike nga tregu i parregulluar.
- FSHU sh.a. deklaroi se për llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike ka përdorur kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për të tre datat kur është realizuar procedura e blerjes së energjisë elektrike.
- Në analizën e dokumentacionit të aplikimit që shoqëria FSHU sh.a. ka depozituar në ERE, evidentohet se nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në pikën 1/ii të vendimit të bordit të ERE-s Nr. 233 datë 20.12.2019, ku citohet se: *Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të japë çdo muaj evidencë të qartë në formën e një bilanci energjitik i cili të mund të argumetojë burimin e mbulimit të kërkesës mujore për klientët e FMF. ERE do të vijojë komunikimin me shoqërinë, që parashikimi I detyrimit të mësipërm të përmbushet.*

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin Nr. 198, datë 12.12.2019 “Mbi lënien në fuqi të vendimit Nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020” është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin Nr. 199, datë 12.12.2019 të Bordit të ERE “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE Nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020” është 1.5 lekë/kWh.
- Duke iu referuar kurseve zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë Euro/Lekë të periudhave kur shoqëria ka realizuar procedurat e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar si dhe në zbatim të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a. si dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin janar 2020, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon.

Çmimi i FMF-së për muajin Janar 2020				
Janar 2020		Njësia	Aplikimi OSHEE Sh.a Çmimi	Propozimi i ERE Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	8.2039	8.204
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin	Leke/kWh	3%	3%
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh	12.49	12.49

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës llogaritëse rezulton që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin **Janar 2020** të jetë **12,49 lekë/kWh**.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

### Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 12,49 lekë/kWh për muajin Janar 2020.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**